

Valbona Sota (1980–). Pedagoge në departamentin e bioteknologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës që prej vitit 2008. Ka kryer shollën e mesme të përgjithshme (gjimnazi "Dhaskal Todri", 1994–1999) në Elbasan. Mbaroi me rezultate shumë të larta studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega biologji 5-vjeçare (1999–2004). Me mbarimin e studimeve të larta u emërua punonjëse shkencore / fiziologe e bimëve në departamentin e fiziologjisë bimore dhe të mikrobiologjisë, sektori i fiziologjisë së bimëve, Instituti i Kërkimeve Biologjike, Akademia e Shkencave, Tiranë (2004 – 2008), ku, krahas punës me interes në kërkimin shkencor për kultivimin dhe konservimin *in vitro* të gjermoplazmës bimore, përfundoi dhe Shkollën e Studimeve Pasuniversitare (SHPU) duke mbrojtur mikrotezën me temë: “Kultivimi *in-vitro* i disa bimëve aromatike mjekësore“, departamenti i biologjisë, FSHN, UT. Në vitin 2012 mori gradën shkencore “Doktor” në programin "Bioteknologji bimore", departamenti i bioteknologjisë, FSHN, UT me temë “Ruajtja e gjermoplazmës së specieve frutore të rrezikuara për zhdukje dhe me vlera ekonomike me metoda të ndryshme të kultivimit *in vitro*”, ndërsa në vitin 2015 mori titullin shkencor “Profesor i asociuar”. Në vitet 2007 – 2011 ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme në Bari, Itali, në kuadër të projekteve ndërkombëtare: *Projekti SIAB, Interreg III, Rivernet Interreg III*, Universiteti i Barit, Itali dhe Trajnim në laboratorët e virologjisë vegjetale të CNR – IVV, UOS Bari për përvetësimin e teknikave të shëndetësimit dhe të diagnostikimit molekular të viruseve dhe viroideve, teknika të aplikuara në materialin bimor të specieve frutore bërthamore. Jep mësim universitar në programet e ciklit I dhe ciklit II të studimeve në disipinën "Bazat e shkencës bimore" dhe "Kulturat qelizore & indore". Gjatë viteve 2003 – 2017 ka qenë bashkëpunëtore në rreth 10 projekte ndërkombëtare dhe kombëtare. Valbona Sota është bashkautore e 2 monografive të botuara nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, autore e tekstit universitar "Kulturat bimore indore dhe qelizore" dhe bashkautore e tekstit universitar "Praktika të kulturave bimore indore dhe qelizore", të dyja botime të Akademisë së Shkencave. Ka udhëhequr rreth 12 teza të ciklit të dytë të studimeve të mbrojtura në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT dhe ka qenë oponente dhe / ose anëtare në komisione të mbrojtjes së doktoratave në FSHN, UT. Është autore e mbi 25 artikujve shkencorë të botuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, nga të cilët në 10 prej tyre është autore e parë. Ka marrë pjesë në rreth 60 simpoziume dhe konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, nga të cilët, në 20 prej tyre është autore e parë.